

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2206 Prot.

Durrës, më 29.09.2025

V E N D I M

Nr. 106, datë 29.09 2025

PËR

"HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË "PSIKOLOGJI KLINIKE", PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës, PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI ME UNIVERSITETIN LA SAPIENZA, ROMË, ITALI"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së, si dhe në propozimin e Njesisë Bazë, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Psikologji Klinike", pranë Fakultetit të Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, program i përbashkët studimi me Universitetin La Sapienza, Romë, Itali, sipas Shtojcës nr. 2 bashkëlidhur.
2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën: **Shqip, Anglisht dhe Italisht.**
3. Kodi i programit të studimit : **P- 72MS - 0313 – SAI.**
4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

